



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:224254

Datë: 30.08.2024

Numri i dokumentit: 06106805

PKR.nr.138/2008

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Fatos Sejdiqaj, me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Tahiri, në çështjen penale ndaj të pandehurve V.R. dhe V.R1. për shkak të veprës penale-Grabitja nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 (tutje:KPPK), duke vendosur sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.124/2008, të datës 23.12.2008, sipas detyrës zyrtare me datën 30.08.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

I.- HEDHET aktakuza e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.124/2008, e datës 23.12.2008, dhe **pushohet** procedura penale kundër të pandehurve :

1. V.R., me nofkën “.....”, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, lindur më datë në Mitrovicë, me vendbanim në fshatin, Komuna e Zubin Potokut, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal dhe

2.V.R1., me nofkën “.....”, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, lindur më datë në Mitrovicë, me vendbanim në fshatin, komuna e Zubin Potokut, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, të dy për veprën penale-Grabitja nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, **për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.**

II.- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

III.- Pala e dëmtuar N.O. me adresë vendbanimi Rr.”.....” Mitrovicë, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

- Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë në këtë Gjykatë me datë 23.12.2008, ka ngritur aktakuzën PP.nr.124/2008, të datës 22.12.2008, ndaj të pandehurve V.R. dhe V.R1., për shkak të veprës penale-Grabitja nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së.

- Këtë lëndë penale Kryetari i Trupit Gjykses e ka pranuar me datën 19.01.2024 dhe pasi që ka pranuar të njëjtën duke shikuar në shkresat e saj, ka konstatuar se në këtë çështje penale për veprën penale për të cilën akuzohen të pandehurit-Grabitja nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, ka arritur afati i parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

- Në nenin 90, paragrafi 1, nën-paragrafi 2 të KPPK-së, përcaktohet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar: *“pesëmbëdhjetë (15) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë (10) vjet burgim”*. Ndërkaq, sipas nenit 91, par.1 të KPPK-së, *“afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale”*, paragrafi 3 përcakton: *“Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer”*, ndërsa paragrafi 4 parasheh : *“Afati i parashkrimit ndërpritet po ashtu kur kryerësi kryen një vepër tjetër penale me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit”*.

- Gjykata, nga shkresat dhe provat që gjenden ne këtë lëndë penale si dhe nga rrethanat e këtij rasti, konstaton se nuk është paraqitur asnjë nga rrethanat që do të ndalonte rrjedhën e parashkrimit të ndjekjes penale, në afatin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, afat ky i paraparë për parashkrim relativ për veprën penale sipas aktakuzës.

- Në rastin konkret të pandehurit janë akuzuar për kryerjen e veprës penale-Grabitja nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, për të cilën vepër penale parashihet dënimi me burgim **prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.**

- Sipas aktakuzës, të pandehurit këtë vepër penale dyshohen ta kenë kryer me datën 26.11.2008, ndërsa veprimi i fundit i ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale është data 23.12.2008, datë kjo në të cilën është dorëzuar në këtë Gjykatë akti formal akuzues-Aktakuza PP.nr.194/2006 nga ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, dhe nga kjo datë e lartëcekur e deri më tani, nuk është ndërmarr asnjë veprim në drejtim të ndjekjes penale.

- Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nga data 23.12.2008, datë kur është ngritur aktakuza, e deri me tani kanë kaluar më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vjet, dhe se brenda kësaj periudhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim me qëllim të ndjekjes penale, që do të ndërpriste rrjedhën e afatit të përshkrimit relativ, çka do të thotë se ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale në bazë të nenit 90, par. 1, nënpar. 2 të KPPK-së.

- Saktësisht, parashkrimi relativ i ndjekjes penale në këtë rast penal ka arritur me datë 23.12.2023, ditë kjo kur janë mbushur pesëmbëdhjetë (15) vjet nga dita kur është ndërmarrë veprimi i fundit në drejtim të ndjekjes penale, ngase brenda kësaj periudhe kohore nuk është ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit relativ dhe nuk ka përfunduar ndjekja penale.

- Gjykata, bazuar në verifikimet që janë bërë përmes Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës (SQEPK) në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, përmes Zyrës për Menagjimin e Lëndëve njoftuar me parashtrësën me shkrim P.nr.138/2008 të datës 30.01.2024 , ka vërtetuar se ndaj të pandehurit V.R. përveç kësaj lënde, janë zhvilluar edhe procedura tjera, respektivisht rezulton i dënuar me aktgjykim të formës së prerë në këto raste :

- a. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.158/2002 i plotëfuqishëm me datë 14.01.2004, për veprat penale-Grabitja nga neni 137 dhe Rastet e rënda të vjedhjes grabitqare dhe Grabitja sipas Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të vitit 1977, për të cilën është paraparë dënim jo më pak se tre vjet.
- b. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok P.nr.5/2003 i plotëfuqishëm me datë 08.04.2006, për veprën penale-Vjedhja e rëndë nga neni 135 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
- c. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok, P.nr.1/2020 i plotëfuqishëm me datë 01.04.2020, për veprat penale-Dhunë në familje nga neni 248 par.2 lidhur me par 3 të KPRK-së, për të cilën është paraprë dënim me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, dhe veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 pika 3.1 të KPRK-së, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

- Ndërsa për të pandehurin V.R1., përveç kësaj lënde, janë zhvilluar edhe procedura tjera respektivisht, rezulton i dënuar me aktgjykim të formës së prerë në këto raste :

- a. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.289/2015, i plotëfuqishëm nga data 07.12.2015, për veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 253 par.1 nënpar 1 të Kodit

të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet.

- b. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok P.nr.5/2003 i plotëfuqishëm me datë 08.02.2006, për veprën penale-Vjedhja e rëndë nga neni 135 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
- c. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok, P.nr.7/2004, i plotëfuqishëm nga data 12.02.2006, për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet.
- d. Lënda sipas Aktgjykim të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.20/2018, i plotëfuqishëm nga data 01.10.2018, për veprën penale Kalim i paautorizuar i vendkalimit kufitar ose vijës kufitare nga neni 146 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082, për të cilën është paraparë dënim me dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
- e. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.30.10.2020, i plotëfuqishëm nga data 30.10.2020, për veprën penale-Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, për të cilën është paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

- Sa i përket të pandehurit V.R. për veprën penale si në pikën (a.), i pandehuri është dënuar para llogaritjes së fillimit të rrjedhës së afatit të parashkrimit të ndjekjes penale, në rastin konkret para datës 23.12.2008, prandaj Gjykata ka konstatuar se në rastin konkret nuk ka pasur ndikim në ndërprerjen e rrjedhës së afatit të parashkrimit relativ.

- Megjithatë, pavarësisht se të pandehurit janë dënuar me aktgjykime të formës së prerë në këto raste, Gjykata konstaton se këto raste penale nuk e kanë ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

- Bazuar në nenin 91, par. 4 të KPPK-së, rrjedhë se afati i parashkrimit ndërpritet kur kryerësi kryen një vepër tjetër penale **me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit**. Referuar aktgjykimeve me të cilat janë dënuar të pandehurit, e të cekura më lartë, të gjitha veprat për të cilat janë dënuar **nuk janë me peshë të barabartë e as më të rëndë me veprën penale sipas kësaj aktakuze**. Të gjitha këto vepra për të cilat të pandehurit janë dënuar kanë dënueshmëri më të ultë, që nënkupton se këto vepra penale nuk e kanë ndaluar rrjedhën e afatit të

parashkrimit, përjashtimisht veprës penale ndaj të pandehurit V.R. sipas verifikimit theksuar në pikën (a.), i cili është dënuar para llogaritjes së fillimit të rrjedhës së afatit të parashkrimit të ndjekjes penale.

- Gjykata konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale ashtu që, pamundëson ligjërisht që Gjykata të ndërmerrë ndonjë veprim në drejtim të ndjekjes penale e për pasojë është rrethanë që pengon ndjekjen penale, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi që të hedh aktakuzën e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.124/08, të datës 23.12.2008 dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurve V.R. dhe V.R1. për veprën penale-Grabitja nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par.1 të KPP-së.

- Vendimin mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, e mori në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 462 par.1 dhe par.3 të KPP-së.

- Nga arsyet e lartcekura e në kuptim të nenit 90, par. 1, nënpar.2 të KPPK-së, e lidhur me nenin 357 par. 1, nën par.1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

- Departamenti për Krime të Rënda -

PKR.nr.138/2008, me datë 30.08.2024.

Kryetari i Trupit Gjykes,

Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tre (3) ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.